



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 18 tetor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 28 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 i Ligjit Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, nenit 5 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, nenit 6 paragrafët 4, 5 dhe 6, neni 7 të Rregullores Nr. 07/2024 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr. 1048/2024 të datës 15 tetor 2024, shpall:

KONKURS

Për Emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit

1. Kandidatët e interesuar për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - 1.1. Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
 - 1.2. Të mos jetë i dënuar për veprë penale, përjashtimit veprave penale të kryera nga pakujdesia;
 - 1.3. Të mos ketë aktakuzë të ngritur, përjashtimisht atyre të ngritura për vepra penale të kryera nga pakujdesia;
 - 1.4. Të ketë vlerësim të dalluar apo të mirë të performancës në dy (2) vlerësimet e fundit të rregullta;
 - 1.5. Të tregojë dhe dëshmojë integritet të lartë dhe aftësi menaxheriale;
 - 1.6. Të mos ketë të shqiptuar sanksion disiplinore, me përjashtim të qortimit apo vërejtjes jopublike në pesë (5) vjetët e fundit.
2. Përveç kriterëve të parapara në paragrafin 1 të kësaj shpallje, për të ushtruar funksionin e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit, kandidati duhet të plotësojë edhe kriteret e veçanta si në vijim:
 - 2.1. Për ta ushtruar funksionin si Kryeprokuror i Prokurorisë Apelit, kandidati duhet të jetë prokuror në Prokurorinë e Apelit apo të ketë së paku shtatë (7) vjet përvojë pune si prokuror i Shtetit, nga të cilat tri (3) vite si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda apo Departamentin për të Mitur.

3. Kandidatët e interesuar për Kryeprokuror të Prokurorisë së Apelit duhet të dorëzojnë:
 - 3.1. Formularin për aplikim;
 - 3.2. Jetëshkrimin e tyre (CV);
 - 3.3. Konceptdokumentin për Kryeprokuror për menaxhimin e prokurorisë përkatëse;¹
 - 3.4. Vetëvlerësimin dhe;
 - 3.5. Dokumentet e tjera relevante për të dokumentuar përvojën e tyre, përfshirë rekomandimet nëse kanë.
4. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon kandidatët e gjinisë femërore dhe kandidatët nga radhët e komuniteteve jo shumicë, që i plotësojnë kriteret e lartë cekura, që të aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.
5. Afati për dorëzimin e aplikacionit është nga data 21 tetor 2024 deri më datë 08 nëntor 2024.
6. Aplikacioni së bashku me dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen te Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Sami Istrefi, në katin e katërt (4) ndërtesa e Këshillit Prokurorial të Kosovës, rruga "Luan Haradinaj" - Prishtinë, të mbyllura në zarf ose me postë.

¹ Formularët e kërkuar në pikën 3.1, 3.3 dhe 3.4 janë të publikuara në uebportalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës dhe mund t'i gjeni në vegzën: <https://prokuroriaks.b-cdn.net/wp-content/uploads/2024/10/Formulari-per-aplikim-per-poziten-e-kryeprokurore-ve-te-prokurorive.docx>